



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 0518 prot

Rrogozhinë, më 24/11/2021

URDHËR

Nr. 085 Datë 24/11/2021

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9, pikal.1, shkronja "b" neni 64 shkronja "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; dhe në zbatim të Ligjit nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar dhe VKM nr. 816, datë 16.11.2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, "Për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

URDHËROJ :

- 1.Miratimin e rregullores "Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidentalitetit" në Bashkinë Rrogozhinë , sipas tekstit bashkëlidhur.
- 2.Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Bashkisë Rrogozhinë.
- 3.Urdhri i përcillet për zbatim të gjitha njësive administrative të Bashkisë Rrogozhinë.

Konc: A.Bakalli

KRYETARI



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: rrogozhine@gmail.com

**BASHKIA
RROGOZHINË**



**RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË INSTITUCIONIN E BASHKISË RROGOZHINË**

Rrogozhinë, Nentor 2021

Bashkia Rrogozhinë

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë e Rrogozhinës, bazohet në ligjin nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Neni 3 Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "I sinjalizuar" janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
2. "Njësia përgjegjëse" është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
3. "Organizate" është autoriteti publik ose subjekti privat.
4. "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.

5. "Sinjalizues" është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
6. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

KREU II

VEPRIMTARIA NJËSISË PËRGJEGJËSE NGRITUR NË BASHKINË RROGOZHINË

Neni 4

Parimet e veprimitarisë

1. "Njësia Përgjegjëse" ngritur pranë Bashkisë Rrogozhinë për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", bazohet në parimin e:
 - a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
 - b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
 - c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktikë të dyshuar të korrupsionit;
 - d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
 - e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
 - f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU III

PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 5

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të "Njesisë Përgjegjëse"-së kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat "Njësia Përgjegjëse" cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo njëzet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të caktuar të “Njesisë Përgjegjëse” dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
 - e. në rastin e sinjalizimit tek “Njësia Përgjegjëse”, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga “Njësia Përgjegjëse” si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatisit dhe të dhënat e sinjalizuara: sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 7
Mosfillimi i hetimit administrativ
1. “Njësia Përgjegjëse” ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse;
 - a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
 - c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të “Njesisë Përgjegjëse”

KREU IV
HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 8
Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. “Njësia Përgjegjëse” nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 9

Parimet e hetimit administrativ nga “Njësia Përgjegjëse”

1. Në kryerjen e hetimit administrativ “Njësia Përgjegjëse” vepron:
 - a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;
 - b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
 - c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
 - d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
 - e. duke ruajtur konfidentalitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
 - f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 10

Procedura e hetimit administrativ

1. “Njësia Përgjegjëse” heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia apo ILDKPKJ-ja zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. “Njësia Përgjegjëse” ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.

3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga “Njësia Përgjegjëse”.
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
 - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
5. “Njësia Përgjegjëse” njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, “Njësia Përgjegjëse” është e detyruar t’i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
6. “Njësia Përgjegjëse” merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga “Njësia Përgjegjëse” rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, “Njësia Përgjegjëse” sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

Neni 11

Provat në hetimin administrativ

1. “Njësia Përgjegjëse” dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e “Njësia Përgjegjëse” kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimit dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e “Njësia Përgjegjëse” vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, punonjësit bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të

detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga inspektorët dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblllokimi i dokumentacionit bëhet me akt të lëshuar e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e prganit të posaçëm.

4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e “Njësisa Përgjegjëse” zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e “Njësisa Përgjegjëse” dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në organizatat private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 12

Përfundimi i hetimit administrativ

1. “Njësisa Përgjegjëse” përfundon hetimin administrativ nëse:
 - a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, “Njësisa Përgjegjëse” njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
 - b. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 60/2016.

2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga “Njësisa Përgjegjëse” i arsytuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 13

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. “Njësisa Përgjegjëse” duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për

Bashkia Rrogozhinë

përmbushjen e një detyrimi ligjor.

3. “Njësisa Përgjegjëse” në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 14

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 15

Afati për vendimmarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga “Njësisa Përgjegjëse” përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të I“Njësisë Përgjegjëse” duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM
“TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI”**

DREJTUAR: Njësia Përgjegjëse të caktuar në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden _____

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më / ____ / ____ në ____ nga _____, punonjës i Njësisë përgjegjëse në _____.

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Njësia përgjegjëse
1-Emër Mbiemër

**FORMULAR I SINJALIZIMIT TË JASHTËM
“TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI”**

Bashkia Rrogozhinë

DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në parages sinjalizimin si më poshtë vijon:

2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkakët e anonimatisit si më poshtë:

Parages këtë sinjalizim në ILDKPKI, për arsye se :

1- _____ nuk ka Njësi përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 60/2016.
dhe parages sinjalizimin si më poshtë:

2- Njësia përgjegjëse në _____ për sinjalizimin e paragjitur më datë _____ (bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë), pranë njësisë;

nuk filloi hetimin administrativ ose e përfundoi atë në kundërshtim me ligjin nr. 60/2016.

zot/zonja _____ që pret sinjalizimin ose zoti/zonja _____ janë përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë personal ose material me objektin e sinjalizimit sepse _____

Dytshoj në integritetin dhe paanshmërinë e Njësisë përgjegjëse për shkak sepse _____

Prova _____ e këtij sinjalizimi që gjendet në _____ fshihet apo shkatërohet nga _____

Bashkia Rrogozhinë

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që parages janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden _____

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më / ____ / ____ , në _____ nga _____ ,
Inspektor në ILDKPKI.

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Inspektor
Emër Mbiemër

FORMULAR KËRKESË PËR MBROJTJE NGA HAKMARRJA
(në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit")

1-Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____, kam paraqitur sinjalizimin në:

a) _____, pranë Njesisë përgjegjëse

b)ILDKPKI
(Bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë)

2-Për shkak të këtij sinjalizimi, pretendoj se jam subjekt i një akti hakmarrjeje të marrë ndaj meje si më poshtë:

Me _____ në _____

Organizatën _____

për shkak se ndaj meje është marrë masa e _____
(bashkëlidhur nëse keni akt shkresor për këtë gjë ose tregoni ku gjendet ai).

Bashkia Rrogozhinë

Në këto kushte mbështetur në nenin 18 dhe 19 të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" parages kërkesën për mbrojtjen nga akti i hakmarrjes ndaj meje, pranë;

1. Njësia përgjegjëse në _____.

2-ILDKPKI, për shkak se;

- a) Nuk ka Njësi përgjegjëse në _____
- b) Njësia përgjegjëse nuk ka marrë masat brenda afatit ligjor 10 ditor, nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje nga sinjalizuesi. (Bashkëlidhur kërkesa për mbrojtje e paraqitur tek njësia përgjegjëse).

1-Ky formular kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, u mor në dorëzim më / ___/___ nga _____, punonjës i njësise përgjegjëse në _____

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Njësia përgjegjëse
1-Emër Mbiemër

2-Ky formular kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja u mor në dorëzim më / ___/___, në _____ nga _____, Inspektor në ILDKPKI.

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Inspektor
Emër Mbiemër